

**Plan Program**  
Klinika Juridike Penale

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti Juridik
<b>Titulli i lëndës:</b>	Klinika Juridike Penale
<b>Niveli:</b>	Themelor
<b>Statusi lëndës:</b>	Zgjedhore
<b>Viti i studimeve:</b>	Viti III
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2 orë
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	5 ECTS
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>E enjte 16:00 – 18:00</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Prof. Dr. Rexhep Murati
<b>Detajet kontaktuese:</b>	Email: <a href="mailto:rexhepmurati@gmail.com">rexhepmurati@gmail.com</a>
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	Klinika Juridike Penale përqendrohet në zhvillimin e aftësive të studentëve për të trajtuar dhe zgjidhur problemet juridike në lëmin penal në mënyrë kritike. Lënda është e ndarë në tri pjesë kryesore: (i) zhvillimi i qasjes kritike në zgjidhjen e problemeve juridike në lëmin penal; (ii) zhvillimi i shkathtësive gjyqësore të studentëve; dhe (iii) aftësimi i studentëve për të artikuluar argumentet juridike në formë të shkruar.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimi kryesor i lëndës Klinika Juridike Penale është që t'i aftësoj studentë të interpretojnë dispozitat ligjore dhe të zgjidhin problemet e ndryshme ligjore nëpërmjet shqyrtimit të rasteve të ndryshme në lëmin e të drejtës penale. Po ashtu në këtë lëndë studentëve do të ju ofrohen njohuri të përgjithshme lidhur me shkathtësitë gjyqësore dhe artikulimin e argumenteve juridike në formë të shkruar. Puna në klasë do të konsistojë në shpjegimin koncepteve të përgjithshme për analizën e fakteve, interpretimin ligjor, zgjidhjen e problemeve ligjore dhe shkathtësive gjyqësore nëpërmjet shqyrtimit dhe studimit të rasteve të ndryshme në lëmin e të drejtës penale.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Rezultatet e pritura nga studentët përfshijnë, por nuk kufizohen në, pikat e përshkruara në vijim: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Studentët do të aftësohen për të dalluar çështjet kryesore në një rast nga lëmi penal;</li> <li>2. Studentët do të aftësohen për të vlerësuar përparësitë dhe dobësitë e rastit varësisht nga cilësia në të cilin bëhet shqyrtimi i rastit;</li> </ol>

	<ol style="list-style-type: none"> <li>3. Studentët do të aftësohen për të aplikuar ligjet përkatëse në faktet e dhëna në rast;</li> <li>4. Studentët do të marrin bazat themelore për ndërtimin e argumenteve bindëse juridike dhe artikulimin e tyre në mënyrë verbale dhe të shkruar;</li> <li>5. Studentët do të marrin njohuri lidhur me ndërtimin e strategjisë së rastit në një proces gjyqësor në lëmin penal si dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve dhe ekspertëve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kryqësore.</li> <li>6. Studentët do të marrin njohuri për mënyrën e hartimit të dokumenteve me rëndësi në një proces gjyqësor në lëmin penal, me theks të veçantë në arsyetimin juridik.</li> </ol>
--	---

**Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**

Aktiviteti	Orë	Javë	Gjithsejtë
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokfiime, seminare			
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgatitja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)			
Projektet, prezantimet, etj			
<b>Totali</b>	<b>2</b>	<b>15</b>	<b>30</b>
<b>Kërkesat e lëndës</b>			
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Puna në klasë do të konsistojë në shpjegimin koncepteve të përgjithshme për analizën e fakteve, interpretimin ligjor, zgjidhjen e problemeve ligjore, artikulimin e argumenteve		

	<p>juridike në formë të verbale dhe të shkruar dhe aplikimin e shkathtësive efektive gjyqësore. Kjo do të arrihet nëpërmjet shqyrtimit dhe studimit të rasteve të ndryshme në lëmin e të drejtës penale.</p> <p>Ligjëratat do të kenë karakter interaktiv dhe studentët inkurajohen të bëjnë pyetje gjatë ligjëratave si dhe të ngrisin pika të diskutimit në kuadër të temës së ligjëratës. Lidhur me këtë, me qëllim të zhvillimit të debatit përmbajtjesor gjatë ligjëratave, studentët ftohen të lexojnë pjesët e literaturës së detyrueshme dhe të rekomanduar para ligjëratave, sipas udhëzimeve të mësimdhënësit. Varësisht nga interesimi i studentëve ligjëruesi mund të organizoj ligjëratat shtesë me mysafirë special për të trajtuar tema të caktuara. Pjesëmarrja në këto ligjëratat është fakultative.</p> <p>Komunikimi ndërmjet studentëve dhe mësimdhënësit do të jetë kryesisht me shkrim, nëpërmjet emailit, në adresën e shënuar më lartë. Ligjëruesi zotohet tu përgjigjet pyetjeve të studentëve deri në 72 orë pas pranimit të emailit. Përndryshe në raste specifike, studentët mund të konsultohen me ligjëruesin personalisht. Në lidhje me këtë, studentët duhet të caktojnë takim me ligjëruesin duke dërguar një kërkesë me shkrim, nëpërmjet emailit, së paku një ditë para datës së sugjeruar të takimit (konsultimit). Në të njëjtën kohë, ligjëruesi do të komunikoj rezultatet e provimit si dhe datën e marrjes së notave nëpërmjet emailit. Në mënyrë të sigurimit të komunikimit të mirë, studentët duhet t'i sigurojnë ligjëruesit email adresat e tyre në fillim të semestrit.</p>
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>Vlerësimi i studentëve përbëhet nga katër kategori kryesore si në vijim: (i) diskutimet gjatë ligjëratave; (ii) pjesëmarrja në punën praktike gjatë ushtrimeve dhe ligjëratave; (iii) punimet në rastet e studimeve dhe (iv) provimi përfundimtar. Kjo metodë e vlerësimit të studentëve ka për qëllim inkurajimin e punës konsekuente gjatë gjithë semestrit. Gjatë vlerësimit kujdes i veçantë do t'i kushtohet aftësisë së kandidatit për të interpretuar dhe analizuar konceptet e ndryshme të mësuara gjatë ligjëratave si dhe prezentimin e tyre koherent, qoftë me shkrim apo gojarisht.</p>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kodi i Penal i Kosovës</b>, që mund të shkarkohet në ueb faqen vijuese <a href="http://gazetazyrtare.rks.gov.net/Documents/Kodi%20Penal%20i%20R.Kosoves%20(shqip).pdf">http://gazetazyrtare.rks.gov.net/Documents/Kodi%20Penal%20i%20R.Kosoves%20(shqip).pdf</a> dhe <a href="http://gazetazyrtare.rks-">http://gazetazyrtare.rks-</a></li> </ul>

	<p><a href="http://gov.net/Documents/Ligji%20per%20ndryshimin%20dhe%20plot%20C3%ABsimin%20e%20Kodit%20penal%20(shqip).pdf">gov.net/Documents/Ligji%20per%20ndryshimin%20dhe%20plot%20C3%ABsimin%20e%20Kodit%20penal%20(shqip).pdf</a>;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Kodi i Procedurës Penale të Kosovës</b>, që mund të shkarkohet në ueb faqen vijuese <a href="http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/Kodi%20i%20procedures%20penale%20(shqip).pdf">http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/Kodi%20i%20procedures%20penale%20(shqip).pdf</a>;</li> <li>• <b>Funk, Markus, Doracaku për Shkathtësi Gjyqësore, 2006</b> që mund të shkarkohet në ueb faqen vijuese <a href="http://www.shppk.org/docs/trial_skills.pdf">http://www.shppk.org/docs/trial_skills.pdf</a> ;</li> <li>• <b>Vendimet e gjykatave të Republikës së Kosovës në lëmin penal</b>;</li> <li>• <b>Vendimet e gjykatave të EULEX-it</b>, që mund të shkarkohen edhe në ueb faqen vijuese <a href="http://www.eulex-kosovo.eu/en/judgments/index.php">http://www.eulex-kosovo.eu/en/judgments/index.php</a>;</li> <li>• <b>Sahiti, Ejup, E drejta e procedurës penale</b>, Universiteti i Prishtinës Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2005; dhe</li> <li>• <b>Murati, Rexhep, Rishikimi i procedurës penale për shkak të provave dhe fakteve të reja</b>, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2006.</li> </ul>
--	--

<b>Literatura shtesë:</b>	United States vs. John Gotti <i>et al</i>
---------------------------	---

<b>Plani i dizajnuar i mësim:</b>	
<b>Java</b>	<b>Tema e Ligjëratisë</b>
<b>Java e parë:</b>	Autorizimet e policisë dhe prokurorit publik në zbulimin dhe hetimin e veprave penale
<b>Java e dytë:</b>	Roli i prokurorit publik në procedurën penale me vështrim të posaçëm në aspektet krahasuese ndërmjet sistemit akuzator dhe sistemit kontinental
<b>Java e tretë:</b>	Arrestimi i përkohshëm/ndalimi policor dhe e drejta në mbrojtje e të arrestuarit/të ndaluarit
<b>Java e katërt:</b>	Shqyrtimi i kallëzimit penal dhe vendosja prokurorit lidhur me bazueshmërinë e kallëzimit penal
<b>Java e pestë:</b>	Hetimi i veprave penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit publik, duke përfshirë zhvillimin e strategjisë së hetimit, vlerësimit të përparësive dhe dobësive të rastit, përcaktimin e veprimeve hetimore, mbledhjen e provave, marrjen në pyetje të dëshmitarëve, ekspertëve dhe të pandehurit
<b>Java e gjashtë:</b>	Kushtet për caktimin e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedure penale
<b>Java e shtatë:</b>	Kushtet për caktimin e masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit

<b>Java e tetë:</b>	Marrëveshja për pranimin e fajësisë edhe dëshmitarët bashkëpunëtorë
<b>Java e nëntë:</b>	Ngritja e aktakuzës dhe përgatitja për seancë kryesore
<b>Java e dhjetë:</b>	Shkathësitë gjyqësore: Fjala hyrëse dhe marrja në pyetje e dëshmitarëve në mënyrë të drejtpërdrejtë
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Shkathësitë gjyqësore: Marrja në pyetje e dëshmitarëve në mënyrë kryqësore
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Shkathësitë gjyqësore: Marrja në pyetje e ekspertëve në mënyrë të drejtpërdrejtë/kryqësore dhe fjala përfundimtare
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Artikulimi i argumenteve juridike në formë të shkruar
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Hartimi i aktakuzës dhe shkresave të ndryshme gjatë procedurës penale
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Arsyetimi i aktgjyqimit në procedurë penale

#### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Gjatë vijimit të ligjëratave nga studentë kërkohet të ju përmbahen standardeve të mirësjelljes akademike në pajtim me Statutin e Universitetit të Prishtinës. Në lidhje me këtë, gjatë pjesëmarrjes në ligjërata dhe kryerjes së punëve akademike studentët, në mënyrë shprehimore, do të ju nënshtrohen ndalimeve si në vijim: (i) Plagjiatura; (ii) Vënia në lajthitje e ligjëruesit; dhe (iii) Kopjimi. Çdo shkelje e këtyre ndalimeve nga ana e studentëve do të raportohet dhe procedohet tek organet kompetente të Universitetit të Prishtinës.